From: "Borana Gjidiaj" <Borana.Gjidiaj@pp.gov.al>
Date: Mar 16, 2018 11:59 AM

I nderuar Z.Matlija,

Ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se pare Durres keni paraqitur kerkesen persa i perket te dhenave nder vite per marredheniet me dhomen e avokatise Durres , te dhena sidomos per ato te caktuar kryesisht.

Ne vijim te verifikimeve te kryera ne kete Prokurori dhe sidomos ne zyren e finances do tju paraqesim ne menyre te permbledhur ato cfare menduam se do te permbushin kerkesen tuaj duke ju shpjeguar se natyra e kerkimeve per rastin ka qene komplekse per sa i perket shtrirjes se verifikimeve nder vite per kete rast, menyres se si jane caktuar avokatet kryesisht duke qene se caktimi i tyre ka qene dhe eshte e bazuar ne nenin 48 te K.Pr.Penal dhe ajo per te cilen duhet bere ky verifikim pervec te dhenave te paraqitura nga zyra e finances te dhenat per cdo rast ndodhen ne cdo ceshtje penale qe ka mbaruar shqyrtimi dhe ndodhen te arshivuara, per kete shkak dhe per arsye se per nxjerrjen e ketij informacioni te kerkuar nga ju kerkonte impenjimin e administrates se Prokurorise tone (k/sekretaria, zyra e regjistrit, zyra e finaces), te cilet ne kete periudhe jane te angazhuar me nxjerrjen e te dhenave te cilat do te jene objekt ne hedhjen e shorteve, qe po zhvillohen per procesin e Vettingut, pergjigjja jone eshte vonuar.

Caktimi I avokateve kryesisht ne ceshtjet penale konkrete, eshte bazur ne listen e avokateve qe ka paraqitur dhoma e avokatise Durres (te cilat jua dergojme bashkelidhur) dhe ne gadishmerine qe kane treguar avokatet per te qene prezent ne ceshtjet e caktuara.

Ne vijim po ju paraqesim te dhenat konkrete lidhur me informacionin e kerkuar nga ju:

Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare Durres bene planifikimin per shpenzime honorare ne total, qe jane te ndare me zera ne te cilat perfshihen:

1.Shpenzime per ekspert te ndare ne: ekspert kontabel, ekspert autoteknik, ekspert ekonomik, ekspert nderitimi e topologjike ekspert PMNZH zjarri, eksperte mjeke ligjore,
2.Shpenzime per perkthyes zyrtare te materialeve leterporosi etj,
3.Shpenzime per avokate kryesisht.

Buxheti per keto shpenzime eshte si me poshte vijon:

Per vitin 2014 = 5.577.401 Leke nga te cilet likuidim avokati =188.000 Leke
Per vitin 2015 =4.304.571 Leke nga te cilet likuidim avokati = 369.000 Leke
Per vitin 2016 = 5.351.646 Leke nga te cilet likuidim avokati = 447.000 Leke
Per vititn 2017 =7.917.582 Leke nga te cilet likuidim avokati =311.800 Leke

Te gjitha faturat e paraqitura per likujdim jane likujduar brenda afatit.

Bashkelidhur ne e-mail keni listat e avokateve te cakutuar kryesisht te depozituara ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Durres, per vitet qe ju kerkoni.

Duke ju falenderuar dhe duke kerkuar mirekuptimin tuaj per vonesen e pergjigjes, ju urojme pune te mbare!

_____ _____

Borana Gjidiaj
Koordinator për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median
Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës